



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:008804
Datë: 02.07.2021
Numri i dokumentit: 01951384

C.nr.605/2019

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari **Betim Behluli**, me bashkëpunëtorin profesional **Armond Omega**, në çështjen juridike të paditësve **V. J., S. D., B. E. - C., A. M., A. D., M. M.** dhe **B. M.** të gjithë nga Rahoveci, si dhe **Sh. M. - Sh.** nga Prishtina të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar avokati **D. M.** nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor **B. O.**, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, shpërblimin jubilar dhe shpenzimeve të udhëtimit, vlera e kontestit **9.487,00 €**, pas mbajtjes përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor, më **24.05.2021**, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditësve **V. J., S. D., B. E. - C., A. M.**, Shenaj Mullaabazi - Sheqiri, **A. D., M. M.** dhe **B. M.** dhe

DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve t'u paguaj kompensim në emër të ushqimit gjatë punës për në lartësi prej 2,00 € për një ditë pune, kompensim për shpërblim jubilar, si dhe kompensim për shpenzimet e udhëtimit prej 70 % nga vlera e paguar si vijon:

- Paditësit të parë **V. J.**, në emër të kompensimit për ushqim në punë për një ditë pune për periudhën kohore 18.04.2017 e deri me dt. 31.12.2019, dhe atë për 456 ditë pune, në vlerë prej 2,00 €, ti paguaj shumën prej 912.00 €, po ashtu në emër të shpërblimit jubilar për 15 vite të punës të i paguaj shumën prej 132,00 € (50% të pagës bazë), përkatësisht shumën e përgjithshme prej 1.044,00 €.
- Paditësit të dytë **S. D.**, në emër të kompensimit për ushqim në punë për një ditë pune për periudhën kohore 18.04.2017 e deri me dt. 31.12.2019, dhe atë për 456 ditë pune, në vlerë prej 2,00 €, ti paguaj shumën prej 912.00 €.
- Paditëses së tretë **B. E. - C.**, në emër të kompensimit për ushqim në punë për një ditë pune për periudhën kohore 18.04.2017 e deri me dt. 31.12.2019, dhe atë për 463 ditë pune në vlerë prej 2,00 € ti paguaj shumën prej 926.00 €.
- Paditësit të katërt **A. M.**, në emër të kompensimit për ushqim në punë për një ditë pune për periudhën kohore 18.04.2017 e deri me dt. 31.12.2019, dhe atë për 456 ditë pune në vlerë prej 2,00 € ti paguaj shumën prej 912.00 €, po ashtu në emër të shpërblimit jubilar për 15 vite të punës të i paguaj shumën prej 128,00 Euro (50% të pagës bazë prej 265,16.00 €), përkatësisht shumën e përgjithshme prej 1.040,00 €.
- Paditëses së pestë **Sh. M. – Sh.**, në emër të kompensimit për ushqim në punë për një ditë pune për periudhën kohore 18.04.2017 e deri me dt. 31.12.2019, dhe atë për 353 ditë pune në vlerë prej 2,00 € ti paguaj shumën prej 706.00 €, po ashtu në emër të shpenzimeve

për udhëtim për 353 dite punë për vajtje dhe ardhje nga shtëpia në punë dhe anasjelltas sipas çmimit të biletës për dy relacione në shumë prej 6,00 euro të i paguaj shumen prej 1.482.00 € (70% i 6,00 euro= 4,20 euro x 353 ditë pune = 1,482,00 euro), përkatësisht shumën e përgjithshme prej 2.188.00 €.

- Paditësit të gjashtë **A. D.**, në emër të kompensimit për ushqim në punë për një ditë pune për periudhën kohore 18.04.2017 e deri me dt. 31.12.2019, dhe atë për 452 ditë pune në vlerë prej 2,00 € të i paguaj shumën prej 904.00 €, po ashtu në emër të shpërblimit jubilar për 15 vite të punës të i paguaj shumen prej 247,00 € (50% të pagës bazë prej 494,98,00 €), përkatësisht shumën e përgjithshme prej 1.151,00 €.
- Paditëses së shtatë **M. M.**, në emër të kompensimit për ushqim në punë për një ditë pune për periudhën kohore 18.04.2017 e deri me dt. 31.12.2019, dhe atë për 455 ditë pune në vlerë prej 2,00 € të i paguaj shumën prej 910.00 €
- Paditësit të tetë **B. M.**, në emër të kompensimit për ushqim në punë për një ditë pune për periudhën kohore 18.04.2017 e deri me dt. 31.12.2019, dhe atë për 456 ditë pune në vlerë prej 2,00 € të i paguaj shumën prej 912,00 €, po ashtu në emër të shpërblimit jubilar për 28 vite të punës të i paguaj shumen prej 404,00 € (75% të pagës bazë prej 539,00 €), përkatësisht shumën e përgjithshme prej 1.316,00 €, si dhe shumën e përgjithshme për të gjithë paditësit gjithsejtë prej 9.487,00 €, me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padis dt.14.12.2019 e deri në pagesën definitive e brenda afatit prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim, **SI ME BAZË**.

DETYROHET e paditura që në po të njëjtin afat, paditësit t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej **2.080,00 €** me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit V. J., S. D., B. E., A. M., Sh. M. – Sh., A. D., M. M. dhe B. M. nëpërmjet përfaqësuesit të tyre të autorizuar kësaj gjykate i kanë ushtruar padinë, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të udhëtimit.

E paditura me parashtresën e saj përgjigje në padi, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve ndaj të paditurës.

Sipas kësaj çështje juridike është caktuar seanca e shqyrtimin kryesor, në të cilën janë paraqitur përfaqësuesi i paditësve avokati D. M., si dhe përfaqësuesi i të paditurës B. O. jurist i diplomuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësve avokati D. M. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, për hir të parimit të efikasitetit procedural kam bërë zgjerimin e padisë ku tash e tutje i propozoi gjykatës që të jenë paditës edhe T. H., Sh. M. – Sh., A. D., M. M. dhe B. M. duke i propozuar gjykatës që ta aprovon këtë zgjerim, ku gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave materiale të dorëzuara me padi dhe provave të reja që i kam bashkangjitur me parashtresën për precizimin e padisë të cilën i dorëzojë gjykatës në kopje të mjaftueshme edhe për palën e paditur, e me të cilat do të vërtetohet në tërësi baza juridike e padisë dhe lartësia e saj. Kërkesa e palëve paditëse për të gjithë paditësit korrespondon me të drejtën në kompensim të ushqimit në punë, shpenzimet e udhëtimit dhe shpërblimit jubilar, e cila është e precizuar me parashtresë dhe që do të vërtetohet me dorëzimin e provave materiale pranë kësaj gjykate, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave

materiale të dorëzuara me padi dhe në shqyrtimin e sotëm në këtë çështje kontestimore është vërtetuar në tërësi lartësia e kërkesëpadisë e cila është precizuar me parashtresë për të gjithë paditësit, ndërsa baza juridike e padisë konsiderojmë që është e pakontestueshme duke iu referuar dispozitave të ligjit të punës dhe kontratës kolektive të arsimit nga e cila mbrojnë edhe të drejtat subjektive civile të cilat janë objekt kontesti sipas padisë andaj gjykatës i propozojmë që padinë e paditësve të precizuar në kuptimin objektiv ta aprovon në tërësi si të bazuar, kërkojmë shpenzimet procedurale të cilat i kemi specifikuar në parashtresën për precizim.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës B. O. deklaroi se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësve dhe precizimin si të pabazuar dhe të pathemeltë ndaj të paditurës komuna e Rahovecit me arsyetimin se të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv duke marrë për bazë se kontrata kolektive është nënshkruar nga organi i nivelit qendror nga MASHT dhe SBASHK ndërsa e paditura nuk ka qenë nënshkruese e kësaj kontrate si nivel lokal kjo në kuptim të nenit 90 paragrafi 2 i ligjit të punës me të cilin është paraparë që kontrata kolektive mund të lidhet në tri nivele. Mbrojtja e të paditurës është në përputhje me përgjigjen nga DKA- ja, me të cilën në parim nuk është kundër të drejtave të mësimdhënësve në bazë të dispozitave të kësaj kontrate që kanë implikime financiare por që në mungesë të mjeteve të alokuara në kuptim të dispozitave të nenit 46 të kësaj kontrate e njëjta ka mbetur e pazbatuar. Në bazë të dispozitave të Ligjit të Punës respektivisht me asnjë dispozitë të këtij ligji nuk është paraparë e drejta e punëtorit të pensionuar apo në marrëdhënie pune në realizimin e të drejtës për pagesën e pagës përcjellëse, shpërblimit jubilar apo shpenzimeve të rrugës, të ushqimit si në kërkesëpadinë e paditësve, konsiderojnë se paditësit nuk kanë shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në procedurë administrative për të realizuar interesin e tyre juridik në kuptim të nenit 24 paragrafi 4 të ligjit numër 06/L-114 për zyrtarët publik. Në aspekt procedural gjykata nuk ka vepruar në përputhje me nenin 67 dhe 68 të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, duke qenë se paditësit janë në marrëdhënie pune në shkollën SH.M.L “Xhelal Hajda-Toni” në Rahovec, i propozojmë gjykatës që kësaj lënde të ia bashkojë edhe lëndë të tjera me paditës nga e njëjta shkollë në emër të parimit të ekonomizimit të procedurës.

Për të vërtetuar faktet vendimtare në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata i ka zbatuar provat duke bërë shikimin e tyre, për paditësin V. J. bëhet shikimi i këtyre provave: bëhet shikimi i kontratës së punës me nr. prot. 210 të datës 22.09.2015, bëhet shikimi i vërtetimit mbi përvojën e punës dhe ditës së prezencës në punë me nr. prot. 144 i 16.02.2021, bëhet shikimi i listës së pagave të datës 27.12.2019 dhe bëhet shikimi i kartelës së lëshuar nga SBASHK-u, për paditësin Sefer Morina bëhet shikimi i këtyre provave: bëhet shikimi i kontratës së punës me nr. prot. 255 i datës 08.10.2015, bëhet shikimi i vërtetimit mbi përvojën e punës dhe ditës së prezencës në punë me nr. prot. 148 i datës 16.02.2021, bëhet shikimi i listës së pagave të datës 27.12.2019 dhe bëhet shikimi i kartelës së lëshuar nga SBASHK-u, për paditësen B. E. - C. bëhet shikimi i këtyre provave: bëhet shikimi i kontratës së punës me nr. prot. 517/20 i datës 18.08.2020, bëhet shikimi mbi vërtetimin mbi përvojën e punës dhe ditës së prezencës në punë me nr. të prot. 135 i datës 16.02.2021, bëhet shikimi i listës së pagave të datës 27.12.2019 dhe bëhet shikimi i kartelës së lëshuar nga SBASHK-u, për paditësin A. M. bëhet shikimi i këtyre provave: bëhet shikimi i kontratës së punës me nr. prot. 209 e datës 22.09.2015, bëhet shikimi mbi vërtetimin mbi përvojën e punës dhe ditës së prezencës në punë me nr. të prot. 131 i datës 16.02.2021, bëhet shikimi i listës së pagave të datës 27.12.2019 dhe bëhet shikimi i kartelës së lëshuar nga SBASHK-u, për paditësen Sh. M. – Sh. bëhet shikimi i këtyre provave: bëhet shikimi i kontratës së punës me nr. prot. 513/20 i datës 18.08.2020, bëhet shikimi mbi vërtetimin mbi përvojën e punës dhe ditës së prezencës në punë me nr. prot. 164 i datës 16.02.2021, bëhet shikimi i listës së pagave të datës 27.12.2019 dhe bëhet shikimi i kartelës së lëshuar nga SBASHK-u, për paditësin A. D. bëhet shikimi i këtyre provave: bëhet shikimi i kontratës së

punës me nr. prot. 203 i datës 22.09.2015, bëhet shikimi mbi vërtetimin mbi përvojën e punës dhe ditës së prezencës në punë me nr. të prot. 126 i datës 16.02.2021, bëhet shikimi i listës së pagave të datës 27.12.2019 dhe bëhet shikimi i kartelës së lëshuar nga SBASHK-u, për paditësen M. M. bëhet shikimi i këtyre provave: bëhet shikimi i kontratës së punës me nr. prot. 506/18 të datës 05.09.2018, bëhet shikimi mbi vërtetimin mbi përvojën e punës dhe ditës së prezencës në punë me nr. të prot 168 i datës 16.02.2021, bëhet shikimi i listës së pagave të datës 27.12.2019 dhe bëhet shikimi i kartelës së lëshuar nga SBASHK-u, si dhe për paditësin B. M. bëhet shikimi i këtyre provave: bëhet shikimi i kontratës së punës me nr. prot. 510/18 të datës 05.09.2018, bëhet shikimi mbi vërtetimin mbi përvojën e punës dhe ditës së prezencës në punë me nr. të prot 133 i datës 16.02.2021, bëhet shikimi i listës së pagave të datës 27.12.2019 dhe bëhet shikimi i kartelës së lëshuar nga SBASHK-u.

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në dispozitat të neneve 7 dhe 8 të LPK-së, duke i vlerësuar deklaratimet e ndërgjyqësve dhe në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe e njëjta është aprovuar.

Gjatë procedurës së provave kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar kontratën e punës për punëtorin teknik V. J. me nr. të prot. 210 e datës 22.09.2015, dhe se nga ky vërtetim, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësi V. J. ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës si Punëtor Teknik në SHML “Xhelal Hajda - Toni” në Rahovec.

Me shikimin në vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr. 144/2021 e datës 16.02.2021 vërtetohet se paditësi V. J. ka përvojë të përgjithshme pune në kohëzgjatje prej 15 vite e 4 muaj, apo gjithsejtë 456 ditë pune.

Me shikimin në kontratën e punës për punëtorin teknik S. D. me nr. të prot. 255 e datës 08.10.2015, dhe se nga ky vërtetim, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësi S. D. ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës si Punëtor Teknik në SHML “Xhelal Hajda - Toni” në Rahovec.

Me shikimin në vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr. 148/2021 e datës 16.02.2021 vërtetohet se paditësi S. D. ka përvojë të përgjithshme pune në kohëzgjatje prej 8 vite e 3 muaj, apo gjithsejtë 456 ditë pune.

Me shikimin në kontratën e punës për mësimdhënësen B. E. - C. me nr. të prot. 517/20 e datës 18.08.2020, dhe se nga ky vërtetim, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësja B. E. - C. ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës si Mësimdhënëse e Psikologjisë në SHML “Xhelal Hajda - Toni” në Rahovec.

Me shikimin në vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr. 135/2021 e datës 22.02.2021 vërtetohet se paditësja B. E. – C. ka përvojë të përgjithshme pune në kohëzgjatje prej 8 vite e 4 muaj, apo gjithsejtë 463 ditë pune.

Me shikimin në kontratën e punës për punëtorin teknik A. M. me nr. të prot. 209 e datës 22.09.2015, dhe se nga ky vërtetim, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësi A. M. ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës si Punëtor Teknik në SHML “Xhelal Hajda - Toni” në Rahovec.

Me shikimin në vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr. 131/2021 e datës 16.02.2021 vërtetohet se paditësi A. M. ka përvojë të përgjithshme pune në kohëzgjatje prej 15 vite e 3 muaj, apo gjithsejtë 456 ditë pune.

Me shikimin në kontratën e punës për mësimdhënësen Sh. M. – Sh. me nr. të prot. 513/20 e datës 18.08.2020, dhe se nga ky vërtetim, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësja Sh. M. – Sh. ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës si Mësimdhënëse e Matematikës në SHML “Xhelal Hajda - Toni” në Rahovec.

Me shikimin në vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr. 164/2021 e datës 16.02.2021 vërtetohet se paditësja Sh. M. – Sh. ka përvojë të përgjithshme pune në kohëzgjatje prej 5 vite e 4 muaj, apo gjithsejtë 353 ditë pune.

Me shikimin në vërtetimin lëshuar nga N.T.Sh “M. – T.”, vërtetohet se çmimi i biletës në relacionin Prishtinë – Rahovec kushton 3,00 € në 1 drejtim.

Me shikimin në kontratën e punës për mësimdhënësin A. D. me nr. të prot. 203 e datës 22.09.2015, dhe se nga ky vërtetim, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësi A. D. ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës si Profesor i Edukatës Fizike në SHML “Xhelal Hajda - Toni” në Rahovec.

Me shikimin në vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr. 126 e datës 16.02.2021 vërtetohet se paditësi A. D. ka përvojë të përgjithshme pune në kohëzgjatje prej 15 vite e 5 muaj, apo gjithsejtë 452 ditë pune.

Me shikimin në kontratën e punës për mësimdhënësen M. M. me nr. të prot. 506/18 e datës 05.09.2018, dhe se nga ky vërtetim, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësja M. M. ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës si Profesoreshë e Matematikës në SHML “Xhelal Hajda - Toni” në Rahovec.

Me shikimin në vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr. 168/2021 e datës 16.02.2021 vërtetohet se paditësja M. M. ka përvojë të përgjithshme pune në kohëzgjatje prej 3 vite e 6 muaj, apo gjithsejtë 455 ditë pune.

Me shikimin në kontratën e punës për mësimdhënësin B. M. me nr. të prot. 510/18 e datës 05.09.2018, dhe se nga ky vërtetim, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësi B. M. ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës si Profesor i TIK-ut në SHML “Xhelal Hajda - Toni” në Rahovec.

Me shikimin në vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr. 133/2021 e datës 16.02.2021 vërtetohet se paditësi B. M. ka përvojë të përgjithshme pune në kohëzgjatje prej 28 vite e 5 muaj, apo gjithsejtë 456 ditë pune.

Sipas dispozitës së nenit 35.8 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017, është paraparë se: ***Punëtorët (anëtar të SBASHK-ut), në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 8.1 për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë 50 % të një page bazë. 8.2 për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë prej 75 % të një page bazë. 8.3 për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë. 8.4 për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë prej 150 % të një page bazë. 8.5 Shpërblimet jubilarë paguhet nga***

punëdhënësit ku i punësuari ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse. 8.6 Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti”.

Sipas dispozitës së nenit 35.7 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017, është paraparë se: “ ***Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore***”.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se, kërkesëpadia e paditësve duhet të aprovohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Si përfundim gjykata vlerësoi se kjo e drejtë i takon paditësve në kuptim të dispozitave të lartcekura, për çka dhe vendosi që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë si të bazuar dhe e detyroi të paditurën që paditësve t’ia paguajë pagat në emër të udhëtimit dhe ushqimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke vërtetuar në këtë mënyrë gjendjes faktike me prova materiale bindëse, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 35.7 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, kjo gjykatë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi kamatën, gjykata e mori në kuptim të nenit 382, të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në harmoni me dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së, dhe vendosi që e paditura t’ia kompensoj paditësve shumën prej 2.080,00 €, e që kanë të bëjnë: për përpilimin e padisë shumën prej 624,00 €, për taksën gjyqësore shumën prej 21,00 €, në emër të përfaqësimit në seancë: 811,20 €, si dhe në emër të përpilimit dhe precizimit të kërkesëpadisë shumën prej 624,00 € .

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
C.nr.605/2019, më 24.05.2021

B. Profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Betim Behluli

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate, për gjykatën e Apelit në Prishtinë – divizionit civil.